



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 61, datë 18.04.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “GODINË HOTELERIE DHE
SHËRMBIMI 4 KAT, ME 2 KAT NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË
HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Eldino” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë hotelerie dhe shërbimi 4 kat, me 2 kat nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Eldino” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor,
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 12/12 2025